

URDHËR
Nr. 185, datë 30.4.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

I. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Sekretarit të Përgjithshëm, për çështjet të mëposhtme:

1. Të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjyimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjyimit të kësaj çështjeje, si dhe t’i nënshkruajë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga sekretari i përgjithshëm, i përcaktua sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit.

4. Të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon shprehimisht ministrit.

5. Të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

II. Këto kompetenca do të ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

III. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku